



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 532 Prot.

Tiranë, më 22 / 04 / 2020

### V E N D I M

**Nr. 38, Datë 22 / 04 / 2020**

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 147, datë 15.11.2019, të bërë nga S.L kundër Bashkisë Klos, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “bindjes politike<sup>1</sup>”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### K O N S T A T O I:

#### **I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Sipas shpjegimeve të dhëna, subjekti ankues në mes të tjerash informon se: “*Me Urdhrin nr. 5, datë 07.08.2015 është emëruar në detyrën, Administrator në Njësinë Administrative Gurrë, Bashkia Klos. Me Vendimin nr. 50, datë 18.09.2019 e kanë larguar nga puna për shkak të marrjes pjesë në një protestë të organizuar nga një subjekt politik opozitar dhe për shkelje të tjera. Ankuesi shprehet se largimi i tij nga puna është bërë për shkak të bindjes politike gjë që e ka vënë në vështirësi ekonomike*”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe kthimin në vendin e punës ose në një vend të së njëjtës kategori.

<sup>1</sup> Referuar Vërtetimit nr. 29, datë 08.11.2019 të lëshuar nga Partia Demokratike e Shqipërisë, Dega Mat, S.L është Kryetar i Seksionit të Partisë Demokratike.

## II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Neni 7 i LMD-së<sup>2</sup>, në pikën 1 të tij, parashikon se: *“Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”*.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Gjatë shqyrtimit të kësaj anese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

**Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:**

Pas analizimit paraprak të ankesës nr. 147, datë 15.11.2019 të S.L u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Në këto kushte, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

- Me shkresën nr. 1698/2, datë 21.11.2019, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga Bashkia Klos për ankesën e bërë nga S.L si dhe ka kërkuar aktet e poshtëcituar:
  - Kopje të dosjes personale të S.L. (Emërime, kontrata pune, vlerësime performance, masa disiplinore, nëse ka, Librezë Pune, etj)
  - Kopje të të gjithë procedurës së ndjekur për largimin nga puna të ankuesit.
  - Kopje të Rregullores së Brendshme të Bashkisë Klos dhe kopje të përkrahimit të punës për pozicionin, Administrator i Njësisë Administrative Gurrë.

<sup>2</sup> Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

- Informacion nëse në vend të ankuesit është emëruar një punonjës/e tjetër.
- Nëse po, një kopje e dosjes personale si dhe kopje të procedurës së ndjekur për emërimin e tij/saj.
- Informacion nëse për të njëjtat shkelje janë larguar dhe punonjës të tjerë nga detyra. Nëse po, një kopje të procedurës së ndjekur për secilin rast.

Me shkresën nr. 2761/1, datë 03.12.2019, Bashkia Klos dërgoi një pjesë të dokumentacionit të kërkuar dhe në mes të tjerash informoi Komisionerin se: *“Administratori i Njesisë Administrative ka detyrë funksionale mbikëqyrjen e zbatimit të investimeve në Njesisë Administrative, dhe subjekti përkatës nuk ka qenë korrekt në vlerësimin dhe marrjen e punimeve në dorëzim në njësinë e tij. Gjithashtu, subjekti ankues ka marrë pjesë në tubimin e datës 19.06.2019, në të cilën janë kryer veprime të kundraligjshme dhe bazuar në Vendimin nr. 17, datë 22.06.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat ky tubim ka qenë i paligjshëm. Gjatë këtij tubimi ka pasur shkelje të kodit të etikës së nënpunësit të shtetit nga administratori përkatës, kjo e normuar në nenin 8, pika 1, 2 të rregullores së brendshme të Bashkisë Klos dhe Ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike” si dhe ka sjellë dëm interesave të ligjshme të shtetit, ka venë në vështirësi funksionimin e rregullt në shërbimin e komunitetit të Njesisë Administrative Gurrë, si rezultat i veprimeve e sjelljeve të paligjshme të datës 19.06.2019. Ndaj S.L si pasojë e këtyre veprimeve është regjistruar procedim penal sipas shkresës nr.1357/1, datë 12.09.2019 nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Mat. Ndërprerja e marrëdhënies së punës është bërë për arsyet e sipërcituara dhe nuk ka lidhje me diskriminimin për “bindjet politike”. Në Njesisë Administrative Gurrë është emëruar K.P dhe emërimi i tij është kompetencë e Kryetarit të Bashkisë”.*

- Me shkresën nr. 1986, datë 30.12.2019, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka kërkuar nga Bashkia Klos, informacion shtesë si më poshtë:
  - Kopje të vlerësimit të punës për vitet 2017, 2018 dhe 6-mujorin e parë të vitit 2019, të S.L.
  - Kopje të plotë të Rregullores së Brendshme të Bashkisë Klos.
  - Kopje të qartë dhe të lexueshme të: Urdhrit të Brendshëm nr.129, datë 05.08.2019, Çertifikatës së marrjes së përkohshme në dorëzim të punimeve për objektin “Shërbime në rrugët e Bashkisë Klos” dhe Procesverbalit të Inspektimit datë 21.08.2019.
  - Informacion nëse për të njëjtat shkelje janë larguar dhe punonjës të tjerë nga detyra. Nëse po, një kopje të procedurës së ndjekur për secilin rast.

Me shkresën nr. 2761/3, datë 08.01.2019, Bashkia Klos dërgoi një pjesë të dokumentacionit të kërkuar dhe në mes të tjerash informoi Komisionerin se: *“Për S.L nuk ka vlerësime pune për vitet 2017, 2018 dhe 6-mujorin e parë të vitit 2019. Mbikëqyrësi i punimeve i subjektit të kontraktuar për të cilin ishin konstatuar defekte në kryerjen e punimeve në objektin “Shërbime në rrugët e Bashkisë Klos”, sipas procesverbalit të inspektimit datë 21.08.2019, ka mbajtur*

*procesverbal mbi korrigjimin e defekteve, ç'ka do të thotë që janë pranuar defektet në realizimin e punimeve sipas procesverbalit të inspektimit datë 21.08.2019 dhe nënkupton që Komisioni i marrjes në dorëzim, ndër ta dhe S.L, nuk kanë qenë korrekt dhe ligjor në marrjen në dorëzim të punimeve sipas çertifikatës së marrjes së përkohshme të punimeve në dorëzim, që kanë nënshkruar”.*

Në përgjigje të shkresës së Bashkisë Klos, ankuesi me e-mail-in datë 10.01.2020 dhe 23.01.2020 në mes të tjerash ka deklaruar se: *“Kërkon nga Bashkia Klos, që të paraqesë aktet provuese në lidhje me mënyrën sesi është bërë vlerësimi i performancës së tij. Bashkia Klos në përgjigjen e saj lidhur me konstatimin e defekteve në kryerjen e punimeve në objektin “Shërbime në rrugët e Bashkisë Klos” nuk ka përcaktuar se të çfarë natyre janë defektet, çfarë vlere monetare dhe funksionale kanë qenë këto difekte si dhe a kanë qenë këto defekte të dukshme apo të përceptueshme në momentin e marrjes së punimeve në dorëzim. Po për personat e tjerë që kanë nënshkruar marrjen në dorëzim të punimeve, a është marrë ndaj tyre e njëjta masë disiplinore, duke zgjidhur marrëdhënien e punës. Ankuesi kërkon nga Bashkia Klos, që të argumentojë se nga ka marrë shkas për të kryer inspektimin e datës 21.08.2019 dhe a është shtrirë ky inspektim në të gjitha njësitë administrative? Lidhur me pretendimin për thyerjen e etikës duke marrë pjesë në tubim, ankuesi thekson se në përfundim të hetimeve nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Mat është konstatuar se S.L nuk ka konsumuar vepër penale dhe është paraqitur kërkesë për pushimin e akuzës”.*

- Mbështetur në nenin 33/8, të Ligjit nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës nr. 147, datë 15.11.2019, Komisioneri me shkresën nr.136, datë 22.01.2020 njoftoi palët për zhvillimin e seancës dëgjimore më datë 30.01.2020, duke kërkuar shpjegime dhe kopje të dokumenteve si më poshtë:
  - Shpjegime lidhur me shkeljen e rregullave dhe normave të etikës gjatë orarit të punës të S.L.
  - Shpjegime lidhur me shkeljet e kryera nga S.L, në marrjen në dorëzim të punëve publike.
  - Informacion nëse për të njëjtat shkelje janë larguar dhe punonjës të tjerë nga detyra. Nëse po, një kopje të procedurës së ndjekur për secilin rast.
  - Subjekti ankues të dorëzojë kopje të vendimit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Mat për pushimin e akuzës në drejtim të veprimeve të tij, të deklaruar në e-mail-in datë 10.01.2020.

Në seancë dëgjimore mori pjesë vetëm përfaqësuesi me autorizim, A.G i Bashkisë Klos<sup>3</sup>. Subjekti ankues nuk u paraqit<sup>4</sup>, dhe si rrjedhim seanca u zhvillua në mungesë të subjektit ankues. Gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesi i Bashkisë Klos, deklaroi se i qëndron parashtrimeve që

<sup>3</sup> Me shkresën, nr. 216, datë 29.01.2020.

<sup>4</sup> Shkresa, njoftim për seancë dëgjimore, dërguar ankuesit, është kthyer nga Posta Shqiptare në datë 03.02.2020, me njoftimin se personi është larguar.

ishin dhënë gjatë komunikimit shkresor me KMD-në. Nga ana e Komisionerit, iu vendos në dispozicion të përfaqësuesit të Bashkisë Klos, kopje të shkresave të dërguara nga ankuesi në datë, 10 dhe 23.01.2020, si dhe iu kërkua që të vinte në dispozicion të Komisionerit, informacionin dhe dokumentacionin mbi pretendimet e subjektit ankues dhe procedurën e largimit nga puna të administratorëve të tjerë, I.Ç dhe J.H.

Bashkia Klos, në vijim të procedurës dhe kërkesave të lëna gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore, nuk vuri në dispozicion të Komisionerit, informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar.

### **III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

#### **A. Lidhur me trajtimin disfavorizues dhe të padrejtë të pretenduar nga ankuesi.**

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka marrë në shqyrtim pretendimet e ankuesit për trajtimin diskriminues në procedurën e ndjekur për largimin e tij nga puna, për shkak të bindjes politike.

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, në nenin 3/1, parashikon se: *“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.*

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me ligjin ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e subjektit ankues, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e tij për trajtim të padrejtë dhe diskriminues.

Bazuar në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, rezultoi se:

Subjekti ankues me Urdhrin nr. 5, datë 07.08.2015 të Kryetarit të Bashkisë Klos është emëruar në pozicionin, Administrator në Njësinë Administrative Gurrë.

Me shkresën nr. 1957, datë 12.09.2019 të Kryetarit të sapozgjedhur të Bashkisë Klos, është bërë njoftimi i S.L për fillimin e procedurës për zgjidhjen e marrëdhënies së punës, *“për shkelje të kodit të etikës së nënpunësit të shtetit, e konkretisht për veprime të ngjarjes së datës 19.06.2019, kjo e normuar në nenin 8, pika 1, 2 të rregullores së brendëshme të Bashkisë Klos dhe Ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike” si dhe duke sjellë dëm interesave të ligjshme të shtetit, duke vënë në vështirësi funksionimin e rregullt në shërbimin e komunitetit, si rezultat i veprimeve e sjelljeve të paligjshme të datës 19.06.2019, si dhe janë konstatuar mungesë korrektësie dhe vlerësimi për procedurat e marrjes në dorëzim të investimeve në Njësinë Administrative Gurrë, duke i sjellë dëm shtetit, të cilat përbëjnë shkelje*

*me faj të rëndë dhe për këtë arsye nuk mund të vazhdojnë marrëdhëniet e punës. Me datë 19.06.2019, rreth orës 13.00, keni marrë pjesë në një protestë e cila sipas dokumenteve zyrtare, konkretisht Vendimit nr. 17, datë 22.06.2019 të Gjykatës së rrethit Gjyqësor Mat, ka qenë protestë e paligjshme, çka ka sjellë shkelje të karakterit civil, neni 8/1 të Rregullores së Brendshme të Bashkisë Klos, duke cënuar reputacionin, dinjitetin duke zhvlerësuar emrin e institucionit që përfaqëson brenda orarit të punës”.*

Me Vendimin nr. 50, datë 18.09.2019 “Për largim nga detyra” është njoftuar S.L për largimin nga detyra e Administratorit të Njesisë Administrative Gurrë, për shkak të shkeljes së rregullave dhe normave të etikës gjatë orarit të punës, si dhe shkeljeve të kryera në marrjen në dorëzim të punëve publike, sjellje dhe veprime këto, të cilat përbëjnë shkelje me faj të rëndë sipas Kodit të Punës.

Referuar Vendimit nr. 17, datë 22.06.2019 të Gjykatës së Shkallës së Parë Mat<sup>5</sup>, S.L dhe shumë punonjës të tjerë të Bashkive Mat dhe Klos kanë marrë pjesë në protestën e zhvilluar në datë 19.06.2019 rreth orës 10.30, e cila në vlerësimin e prokurorisë, ka qenë protestë e kundërligjshme, pa leje përkatëse nga organet kompetente, ka patur kundërshtime, dhunë, e cila ka degraduar në përleshje fizike midis forcave të rendit dhe protestuesve, por që nga gjykata është vlerësuar se në drejtim të të dyshuarve (mes tyre dhe S.L) nga ana e prokurorisë, nuk janë pasqyruar rastet e dhunës.

Me shkresën nr. 1357, datë 12.09.2019, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Mat, në mes të tjerash, ka informuar Bashkinë Klos se nga verifikimi i regjistrave penalë, shtetasi S.L është i regjistruar në aktet e procedimeve penale nr. 92 dhe 99 të vitit 2019 për veprat penale: “Dëmtimi me dashje i materialit zgjedhor”, “Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik”, “Organizimi dhe pjesëmarrja në grumbullime e manifestim të paligjshme” dhe “Prishja e qetësisë publike” dhe se procedimet penale të mësipërme janë në fazën e hetimeve paraprake.

Në pikën 1 dhe 2 të nenit 8 të Rregullores së Brendshme të Bashkisë Klos, përcaktohet se: *“1.Nëpunësit dhe punonjësit e Bashkisë Klos duhet të ruajnë reputacionin, dinjitetin, si dhe të qëndrojnë larg çdo veprimi, qëndrimi apo sjellje e cila mund të zhvlerësojë emrin e mirë të nëpunësit dhe institucionit që përfaqëson”,* ndërsa në pikën 2 përcaktohet: *“2. Nëpunësit dhe punonjësit e Bashkisë Klos janë të detyruar tu përmbahen normave të etikës gjatë orarit të punës”.*

Në pikën 11 “Masat disiplinore” të rregullores së sipërcituar përcaktohet se për punonjësit që janë me kontratë pune zbatohet Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Subjekti ankues ka ngritur pretendimin se shkarkimi nga detyra si Administrator i Njesisë Administrative Gurrë ka ardhur për arsye se, është anëtarë i subjektit politik, Partia Demokratike

---

<sup>5</sup> Referuar citimeve në faqet 3, 4 dhe 13 të vendimit të gjykatës.

e Shqipërisë<sup>6</sup> (PD), ndërkohë që në zgjedhjet vendore të datës 30.06.2019, Kryetar i Bashkisë Klos është zgjedhur z. I.H, kandidat i mbështetur nga subjekti politik, Partia Socialiste e Shqipërisë.

Mbështetur në shkresën Nr. 1957, datë 12.09.2019, të Bashkisë Klos, konstatohet se largimi i ankuesit nga detyra është bërë duke iu referuar nenit 153 dhe 154, të Kodit të Punës. Pra, sipas pretendimit të Bashkisë Klos, largimi i ankuesit nga detyra është bërë për shkaqe të justifikuara që nuk lejojnë, sipas parimit të mirëbesimit, vijimin e marrëdhënieve të punës.

Ligji nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, në nenin 64/ë të tij, Kompetencat dhe detyrat e kryetarit të bashkisë, ka përcaktuar se: *“Kryetari i bashkisë ka këto kompetenca dhe detyra: ë) emëron, duke respektuar ligjin për barazinë gjinore, administratorët e njësive administrative/ lagjeve dhe i shkarkon ata”*.

Referuar dokumentacionit të administruar gjatë procesit të hetimit, lidhur me largimin nga puna të S.L për shkak të shkeljes së rregullave dhe normave të etikës, rezulton se ankuesi, në datë 19.06.2019, ditë e mërkurë, nga ora 10.30 deri në mesditë, brenda orarit zyrtar, ka marrë pjesë në një protestë, në të cilën ka pasur dhe veprime të dhunshme nga ana e protestuesve, duke dëmtuar mjediset e KZAZ-së dhe materialet zgjedhore që do të shërbenin për zgjedhjet vendore të datës 30.06.2019.

Vendimmarrja e bashkisë për sa i përket shkeljes së rregullave të etikës nga ana e S.L, është brenda kompetencave të Kryetarit të bashkisë, bazuar në parimin e mirëbesimit dhe raportit të ngushtë që duhet të ekzistojë mes Kryetarit të bashkisë dhe Administratorit të njësisë, dhe për rastin konkret shërben si një shkak i justifikuar për zgjidhjen e marrëdhënies së punës.

Për sa më sipër, në referencë të nenit 7, pika 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri gjykon se subjekti ankues nuk është ekzpozuar para një trajtimi të padrejtë dhe të paligjshëm nga ana e Bashkisë Klos.

Në mungesë të këtij trajtimi, Komisioneri gjykon se nuk kemi të bëjmë me diskriminim për shkakun e bindjes politike, të pretenduar nga ankuesi.

Ndërsa, sa i takon pretendimit të ankuesit lidhur me mosmarrjen e masave disiplinore për anëtarët e tjerë të Komisionit për marrjen përfundimtare në dorëzim për objektin “Shërbime në rrugët e Bashkisë Klos” të ngritur me Urdhërin e Brendshëm nr. 129, datë 05.08.2019, Komisioneri vlerëson, se referuar dokumentacionit të dorëzuar nga Bashkia Klos, Procesverbal inspektimi nr.1808, datë 21.08.2019 dhe Procesverbalit për korigjimin e defekteve të punimeve në objektin “Shërbime në rrugët e Bashkisë Klos”, nr.2449, datë 29.10.2019, rezulton e provuar se në objektin e marrë në dorëzim nga komisioni ka pasur defekte të cilat janë riparuar më vonë, dhe për S.L mund të jetë konsideruar si situatë rënduese në procedurën për largimin e tij nga

---

<sup>6</sup> Referuar vërtetimit nr.29, datë 08.11.2019, S.L nga viti 2014 është Kryetar i Seksionit të Partisë Demokratike.

puna, për arsye se ka qenë në cilësinë e kryetarit të këtij komisioni, ndërsa dy personat e tjerë kanë qenë në cilësinë si anëtar të komisionit.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenin 18 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 9, të Ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), nenin 1, nenin 7, pika 1, nenet 11-13, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 10-11, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të shtetasit S.L nga ana e Bashkisë Klos për shkak të bindjes politike.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**Robert GAJDA**

**KOMISIONER**